REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 98 - 105/17
Datë/Datum. 24.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Ministria e Infrastruktures**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP** **Nr.98/17** **Nr.105/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë"**, me nr. prokurimi: **MI-16-050-511.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE NPN " Renelual Tahiri"-Prizren** **OE "2A grup sh.p.k & G.P.G Company sh.p.k- Prishtinë**		
Datë	**24.04.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë"**, me nr. prokurimi: **MI-16-050-511,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastruktures,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorëve ekonomik: **NPN "Renelual Tahiri"- Prizren,** me nr.prot. 98/17, e datës 08.04.2017, dhe **OE "2A grup sh.p.k & G.P.G Company sh.p.k- Prishtinë,** me nr. prot .105/17, e datës 11.04.2017.

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

	12.04.2017		13.04.2017		24.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP-së - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 08.04.2017 dhe 11.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 98/17, dhe 105/17, e parashtruar nga operatorët ekonomik **"OE NPN " Renelual Tahiri"- Prizren, dhe OE "2A grup sh.p.k & G.P.G Company sh.p.k- Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë", me nr. prokurimi: MI-16-050-511, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Infrastruktures.

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: OE NPN " Renelual Tahiri"-Prizren
N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: OE "2A grup sh.p.k & G.P.G Company sh.p.k- Prishtinë

Pikat e Ankesës:

Operatori Ekonomik Ankues: NPSH OE NPN " Renelual Tahiri"-Prizren.

- Neni 1 i LPP-së, (Qëllimi) l. Para, 1.2.3
- Neni 6 i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) Par.,1,2,3
- Neni 7 i LPP-së, (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) Par. 1,2,3,4,5,6,
- Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), Para 1,2,3,4,5,
- Neni 60 i LPP-së, (Kriteret për Dhënien e Kontratës), Par.1 Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.
- Neni 62 i LPP-së, (Përfundimi i aktivitetit të Prokurimit).
- Neni 72 i LPP-së, (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji).

Operatori Ekonomik Ankues: OE "2A grup sh.p.k & G.P.G Company sh.p.k- Prishtinë.

- Neni 1 i LPP-së (Qëllimi),
- Neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi),
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

- Neni56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet: OE NPN "Renelual Tahiri":
Shkelja e nenit 62 të LPP konsiston se nuk janë plotësuar/përmbushur asnjë kusht ligjor nga neni 62 dhe nga paragrafët vijues për anulimin e aktivitetit të PP të larte theksuar dhe si të tillë i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-ja, ta anuloj vendim dhe lëndën ta kthej në rivlerësim

Autoriteti Kontraktues Ministria e infrastrukturës -MI,me vendimin e saj te date 30 03 2017 e ka anuluar aktivitetin e prokurimit Publik me Nr të referencës AP:MI 16 050 511 Asfaltimi i Rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë". Anulimi i tenderit është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe duke shkelur LPP gjegjësisht neni 62 mbi arsyet e anulimit e tenderit

Me LPP nuk kërkohen 3 (tre) oferta të përgjegjshme për aktivitetin prokurimit në fjalë sipas Ligjit të Prokurimit Publik, aktual, kur deri me tani lidhur me këtë aktivitet të PP, janë zhvilluar gjithsej një vlerësim dhe 2 rivlerësimeve nga AK dhe janë mxjerrur 2 vendime të OSHP-së, dhe 1 (një) Konkluzion, dhe Aktiviteti i PP ka filluar në maj të vitit 2016 dhe zgjatë deri me sot

AK, ne Letra standard për tender të eliminuar" e ka anuluar aktivitetin e prokurimit publik me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për 3 (tre) oferta të përgjegjshme. Ky anulim në arsyetimin e tij ka nënvizuar vetëm një fakt dhe arsye ndaj një OE , duke ju referuar ne mënyrë të kundërligjshme vendimit të 2(dytë)të OSHP-së, me reference nr 398,401 dhe 403/16 në arsyetimin CITAT: AK thuhet

"Keni dështuar në përmbushjen e kërkesave mbi gjendjen e ekonomike dhe financiare , respektivisht pik 8.1.2, Kapitali i mjaftueshëm për realizimin e kontrate (mjete të gatshme në xhirollogarinë nga Kompania në Bankë në vlerë prej se paku 200.000.006 ose qasje të pakushtëzuar në kredi) Sipas vendimit te OSHP-se nr 398, 401 dhe 403/16 m e te cilin ne pikë e ka konsideruar të përgjegjshëm një nga OE konkurrues".

AK nuk ka dhëne shpjegime me shkrim dhe në vendimin e tij se për çfarë arsye janë eliminuar OE tjerë konkurrues dhe cilat janë arsyet e eliminimit të aktivitetit të prokurimit Publik me VENDIM

Me vendim të OSHP-së, lënda (2) here është kthyer në rivlerësim Kjo situate vjen pas rivlerësimit të dytë ky kryhet rivlerësimi dhe rekomandohet për të ju dhënë kontrata një OE, që nuk është as OE i parë e as OE i dytë por i 3 (tretë), në vlerë prej rreth 370 mije urove me i shtrenjte se sa operatori i parë

OE fitues në rundin e parë e gjatë punës së rivlerësimit të dytë e paraqet rastin në Agjencinë Kundër korrupsion-AKK, dhe pas kryerjes së punës të komisionit të dytë të rivlerësimit. Me vendim të OSHP-së, proces është kthyer në rivlerësim 20dy) dy here radhazi dhe ky fakt nuk ishte paraqitur si vendimtar në kuptimin e plotësimit të kushteve ligjor në raport me pergjegjëshmërine dhe plotësimin e kushteve të OE për 3 (tre) oferta të përgjegjshme

Vendimi për anulimin merret në ditën kur Agjencia kundre Korrupsion -AKK, e adreson lëndën në fjalë tek organet kompetente/ polici për krime ekonomike/Prokurori dhe nuk jep fare opinion AK me shkrim se si do të duhej të veproj, edhe pse ky opinion nuk është obligativ mirëpo ne raste të caktuar merret i orientim për zgjidhen e rastit

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik -OSHP, të, me vendim e tije të 2(dytë) e obligon AK Kontraktues Cita:

Panel shqyrtues obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave të vlerësoj dhe shqyrtoj për të gjithë Operatoret e ekonomik Ofërtuese, se a e kanë përmbushin kërkesën në lidhje me deklaratën nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar pasi që sipas deklarimit ta përfaqësuesit të AK-së, në seancë dëgjimore për shqyrtim kryesor së asnjeri OE-ve, ofertuese nuk e plotësojnë këtë kërkese të AK të njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit. "

Konkluzion OSHP-ja, i date 29 dhjetor 2016 e ka ndryshuar dhe rrjedhimisht dhe logjikisht nuk është në fuqi vendimi i datës 09 dhjetor 2016

AK është dashur te procedoj me shpalljen e fituesit

-Ndërsa me konkluzion të OSHP-së, të datës 29 dhjetor e ndryshon te njëjtin vendim dhe i hiqet citati i lartshënuar dhe zëvendësohet si në vazhdim CITAT:

Paneli shqyrtues konstaton se është i qëndrueshme pretendimi ankimor OE ankues se OE i rekomanduar për kontratës nuk e ka përmbushur kërkesën me lidhje me Letrën e përkrahjes nga Banka, në vlerë për 200.0006, për faktin se OE, i rekomanduar për kontrate nuk ka dëshmuar s ka depozita apo mjete të gatshme në shumën e lartcekur si dhe nuk ka ofruar dëshmi se ka akces në kredi të pakushtëzuara edhe pse përfaqësuesi i AK në seance dëgjimore sqaroj se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar mbështetje si të gjithë OE-të, "

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet: OE "2A Group sh.p.k & G.P.G Company" sh.p.k:
Ne baze te qasjes ne komplet dokumentacionin ne lidhje me proceduren e aktivitetit te prokurimit me titull: "Asfaltimi i Rruges Babush-Tern-Luboc-Koshare-Slivove", te cilin e kemi pasur me date 27.03.2017 prane AK-se, kemi konstatuar se AK-ja me rastin e eleminimit tone si dhe me anulimin e ketij aktiviteti ka bere shkelje te renda te LPP-se te cilat do ti pershkruajme me poshte:

Nga raporti i ri- vleresimit te tendereve i dates 25.01.2017 kemi kuptuar se ne si OE jemi rekomanduar per dhenje te kontrates, madje ky komison ka vleresuar edhe mbeshtetjet bankare te OE-ve pjesemarres kjo pasi ka qene kerkese edhe e OSHP-se dhe te njejtin ne baze te vleresimit te mbeshjtetjeve bankare te OE-ve kane vleresuar se mbeshtetja bankare e OE "2A Group & G.P.G Company. Shpk" eshte e plotesuar ne baze te njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit.

Por edhe pse ne si OE jemi te shpallur te pergjegjshem nga Besim Tahiri ne rivleresimin qe ky individ i ka bere dosjes sone ku i njejti permes nje dokumenti ne nr.prot: 04/5424 te dates 25.10.2016 ka thene siq citoj: "Oferta e 2A Group & GPG. Company konsiderohet e pergjegjshme por e renditur nr.2 si oferte e pergjegjshme" dhe gjithashtu jemi shpallur te pergjegjshem nga 3 (tre) komisione vleresuese brenda AK-se madje dy prej tyre komisoneve na rekomandojne neve si OE per dhenje te kontrates, perseri Besim Tahiri (U.D. Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit) koke me vete njeher vendos te shperblej me kontrate OE

Gerica&Beni Com dhe kur ne OSHP konstatohet se ky OE eshte i papergjegjshem dhe lenda kthehet ne ri-vleresim, Besim Tahiri edhe kesaj rradhe edhe pse perseri komisioni i ri-vleresimit na rekomandon neve si OE per dhenje te kontrates ky per te dyten here rradhazi del kunder vetvetes dhe kunder raporteve te vleresimit dhe kesaj rradhe anullon kete aktivitet te prokurimit me pretendimin se nuk jane tri oferta te pergjegjshme. Ne baze te LPP-se nuk kerkohet qe te jene tre oferta te pergjegjshme por mjafton te jete vetem nje dhe AK-ja mund te vazhdoj me dhenje te kontrates, por nuk eshte çudi qe ky zyrtar nuk ka njohuri te mira te LPP-se.

Sa i perket mbeshtetjes bankare qe ne kemi ofruar per kete aktivitet te prokurimit ju sqarojme se ne kete dokument eshte shume qarte e shenuar se: "Kompania 2A Group Shpk ka kapacitete te mjaftueshme financiare dhe Banka ne te ardhmen mund ta perkrah me kredi, leter-kredi, garancione bankare, nese kerkesat e tij jane ne harmoni me ekspozimet kreditore te lejuara nga ligji per bankat, rergulloret e BQK-se dhe politikat e procedurate BPB-se." Pra BPB ne baze te kerkesave te dosjes se tenderit ka konfirmuar se kompania 2A-Group ka kapacitete te mjaftueshme financiare dhe gjithashtu ka konfirmuar se nese kompanise ne te ardhmen (sepse per rastin konkret ka kapacitete te mjaftueshme) i nevojitet ndonje kredi ose qfaredo ekspozimi tjeter atehere banka do ta perkrah kete klient ne harmoni me procedurat e bankes. Jemi te bindur plotesisht se kjo mbeshtetje bankare i ploteson kerkesat konform njofimit per kontrate dhe dosjes se tenderit (e cila eshte vertetuar nga 3 komisione vleresuese te AK-es), por ky pertendim i Besim Tahirit eshte tendencioz dhe i qellimshem dhe jemi te bindur se ky zyrtar ne qfare do menyre eshte munduar ta shperbleje me kontrate te preferuarin e tij (siq eshte ne kete rast OE Gerlica), dhe kur nje gje e tille nuk ka qene e mundur atehere ky zyrtar vazhdon te gjeje pretendime te paqendrueshme me qellimin e vetem qe neve si OE te na diskriminoj dhe mos te na shperbleje me kontrate.

Sa i perket arsyetimit te ketij zyrtari i cili pretendon se kinse deshiron te mbroj buxhetin e Republikes se Kosoves, konsideroj se ky pretendim i ketij zyrtari eshte kontradikor dhe se i njejti nuk ka se si te mbroj buxhetin e RKS-se kur per kete tender ne dosje te tenderit eshte parashikuar vlera prej 2,950,000.00€ nga vet AK-ja, ndersa ne si OE kemi ofertuar me nje cmim prej 1,000,000.00€ me te lire sesa parashikimi qe vet AK-es ka per kete projekt, prandaj ky pretendim i ketij zyrtari eshte i papranueshem dhe tendencioz dhe me qellimin e vetem te diskriminimit te neve si OE.

Prandaj bazuar ne shkeljet e evidentuara me larte kerkojme nga OSHP-ja qe ti trajtoje te gjitha keto shkelje dhe ta detyroi kete zyrtar te vazhdoi tutje me dhenien e kontrates neve si OE meqenese dy here jemi rekomanduar si fitues te ketij tenderi nga dy komisione vleresuese brenda AK-es dhe gjithashtu te marre masa ndaj ketij zyrtari meqenese shihet

mjaft qarte se ky zyrtar po perdor praktika te keqija dhe diskriminuESE ndaji neve si OE.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :	20.04.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16):	Punë/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	03.06.2016
Data e hapjes së ofertave (N.58):	03.06.2016-ora 14;30h

Data e njoftimit për eliminim të OE ankues	24.03.2017
Kriter për dhënien e kontratës	Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vërejtje
1	RENELUAL TAHIRI	PRIZREN	/	1,379,792.59€	JO
2	BAGERI	FERIZAJ	/	1,648,429.40€	JO
3	DINO	LIPJAN	/	2,149,954.47€	JO
4	ESKAVATORI	FERIZAJ	/	2,028,880.72€	JO
5	BENI COM/GËRLICA	PODUJEV/FR	/	1,758,143.44€	JO
6	AL TRADE	PRISHTINË	/	2,287,983.47€	JO
7	DRINI COMPANY	PRIZREN	/	2,185,961.36€	JO
8	LEDI ING	SHTIME	/	2,235,842.43€	JO
9	STRASSEN TIEFBAU	FERIZAJ	/	2,043,668.10€	JO
10	2A GROUP	PRISHTIN	/	1,977,440.82€	JO
11	FAMIS CO	PRISHTIN	/	2,485,377.86€	JO
12	PAPENBURG&ADRIANI	FERIZAJ	/	1,865,726.56€	JO
13	TEKNIKA PROJEKT	SUHAREKË	/	1,799,999.99€	JO
14	BEGISHOLLI&CONEX GROUP	FERIZAJ/PR	/	1,987,664.05€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë katërmbëdhjet (14) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 65.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesa e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar - kërkohet vetëm pë fituesin e e tenderit.

<u>Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë</u>:

- **Një deklarata nën Betim**, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. – Origjinal.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, **pika 2 dhe 3**, do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesat

1. Regjistrimi i OE në regjistrin profesional,komercial ose korporatës në vendin e themelimit e përkthyer në gj.shqipe,angleze ose sërbe.(Ofertuesi jo rezident sipas Ligjit aktual të Kosovë LPP Nr 04/L-042) është i detyruar të paraqesë çertifikaten e regjistrimit të njësisë përhershme-para nënshkrimit të kontratës
2. Regjistrimi i TVSH i OE
3. Numri fiskal i OE

Dëshmitë dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se
3. Kopja e numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesat

1. Operatori Ekonomik duhet ti ofroj deshmi Autoritetit Kontraktues për qarkullim prej së paku 1,500,000.00 € në tri vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015).
2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompanija në bankë në vlerë prej së paku 200,000.00 €, ose qasje te pakushezuar ne kredi).

Dëshmia e kërkuar

1. Raporti Auditorit duhet te jete me rezultat pozitiv financiare, i shoqeruara me pasqyra financiare të operatorit ekonomik për tri vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015), i çertifikuara nga Auditori i Licencuar ose ndonje Kompani e Auditimit (të bashkëngjitet kopja e noterizuar e liqencës për Auditim).
2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose çasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesat

1. **Menaxher i projektit**

- Inxhinier i diplomuar : 3 vite përvojë punë pas diplomimit.
- Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).
- OE duhet të na siguroj se të njejtin staf profesional (inxhinierin) nuk e ka të angazhuar edhe në projekte tjera të cilat janë në realizim nga MI-ja.

2. Udhëheqësi i punishtes

- Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë: 2 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve.
- Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.
- Vlera e projekteve të udhëhequra min. 500,000.00 euro.
- OE duhet të na siguroj se të njejtin staf profesional (inxhinierin) nuk e ka të angazhuar edhe në projekte tjera të cilat janë në realizim nga MI-ja.

3. Gjeodeti

- Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me 2 vite përvojë pune pas diplomimit ose Gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit.
- Minimum 2 projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

4. Listen e kontratave

- Jo më pak se 2,000.000.00 €, të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare (2013, 2014 dhe 2015) .

5. Mjetet,stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit :

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I targave,mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj)
1.	Eskavator, kapac. 0.4 - 1 m^3	1		
2.	Eskavator, kapac. 3-4 m^3	3		
3.	Eskavator me çekan pneumatic	1		
4.	Kamion kapacitet 10 m^3 Kipper.	6		
5.	Ngarkues, kapac. 0.4 - 1 m^3	2		
6.	Ngarkues, kapac. 3-4 m^3	1		
7.	Cilindër 12 t,vibrues	2		
8.	Cilindër 12 t me dhëmbëza,vibrues	1		
9.	Grejder 12-16t	1		
10.	Autopompë betoni	1		
11.	Kamion për transport të betonit të gatshëm	2		

12.	Cisternë për karburante	1		
13.	Vibrator për beton	1		
14.	Paisjet për prerjen dhe lakimin e armatures	1		
	Pajisjet e nevojshme për punët e asfaltit			
15.	Finisheri për shtrirjen e asfaltit	1		
16.	Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur) 7-8 t	1		
17.	Cilindrat me rrota hekuri me vibrim 12t	1		
18.	Cilindër me rrota hekuri me vibrim 3 t	1		
19.	Cisternë (tanket) e ujit	1		
20.	Spërkatës për bitumen dhe emulsion	1		
21.	Kamion për transport të asfaltit të gatshëm	6		

6. Bazë për prodhimin e asfaltit e licencuar , në pronësi, apo marrëveshje për furnizim me asfalt.
7. Gurëthyes i licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr(agregat).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deshmia 1-3

Kopjet e Diplomave përkatëse të noterizuara, CV, Kontratat e punës të noterizuara dhe Referencat qe deshmojn se kan kryer me sukses projektet sipas kerkesave, si dhe nje deklarat nen betim nga stafi profesional i angazhuar per kete projekt se nuk eshte i angazhuar edhe ne mbikqyrje te projekteve tjera te cilat jan ne realizim nga MI.

Deshmia 4

Te paraqiten: referenca/procesverbalet e pranimit pëfundimtar të punëve te leshuar nga punedhensit e tyre, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar.

Deshmia 5
OE duhet te sjell dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), te noterizuar nga Noteri që dëshmon se OE te gjitha keto pajisje i ka ne dispozicion për realizimin e këtij projketi.

Deshmia 6 dh 7
Licenca valide të lëshuara nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Nebi LUZHA: Kryesues,
Agron BESHIRI: Anëtar,
Mimoza BINAKAJ; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë : 31.01.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Në bazë të kritereve të përcaktuara në njoftim për kontratë dhe dokumentacion tenderues, komisioni për vlerësim të ofertave i emëruar me vendimin e datës 27.12.2016, me nr. Të referencës 6972/2016, i cili filloi punën me datë 23.01.2017, pas procesit të ri-vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve konstatoi se 14 operatoret ekonomikë të cilet kanë ofertuar për projektin "Asfaltimi i rruges Babush-Tërn-Lubovc-Koshare -Slivovë", vetëm një (1) OE i plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, ndërsa 13 OE të tjerë janë të papërgjegjshëm pasi NUK i kanë plotësuar kërkesat e Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Kriteri për dhënien e kontratës është "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët".

Komisioni ri-vlerësimit në mënyr unanime rekomandon për dhënien e kontratës OE: "2A GROUP&G.P.G Company" Prishtinë/Lushnje, me çmim prej 1,977,440.82€.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për punë, vlerë të madhe, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për punë, vlerë të madhe, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

Pretendimi ankimor nr.1- RENELUAL TAHIRI,
Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues sa i përket pikave :

- 1.Identifikimi financiar është prezantuar ne kopje,(nevojitej Origjinali pjesa V e Kontratës)
- Mungon Sigurimi i tenderit, (Vazhdimi i vlefshmërisë së Sigurimit) Mungon Çertifikata e Auditorit e Noterizuar është ofruar në kopje.
- Listën e kontratave kopje,
- Vërtetimi Tatimor, (me afat të skaduar)
- Mungon Letër përkrahje nga Banka në vlerë prej 200 000 € është ofruar në vlerë vetëm 100 000€.
- Mungon Deklarata nën Betim nga OE për Menaxherin e Projektit dhe Udhëheqësin e Punimeve (Agim Dergutin dhe Izahir Kuka) se nuk janë të angazhuar edhe në projekte tjera që janë në realizim nga MI-ja sipas 9.1 dhe 9.2. Gjithashtu edhe CV-it, e tyre nuk janë të nënshkruara.
- Lista e pajisjeve për realizimin e projektit nuk është e formës standarde sipas FDT-së,
- Nuk ka dorëzuar specifikimet teknike te detyrueshme te Aneksit 1. te dosjes se tenderit.

Pretendimi ankimor nr.1- RENELUAL TAHIRI,
Në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga OE ankues sa i përket eliminimit nga ana e autoritetit kontraktues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendimet ankimor janë shqyrtuar disa herë në OSHP-së, dhe në bazë të vendimit të P.SH vendimi nr.398-401-403/16 i datës 20 Dhjetor 2016, në lidhje me këtë, Paneli shqyrtues ka vendosur në lidhje me këtë pretendime ankimor të parashtruar nga OE ankues, njëherit Eksperti shqyrtues njofton Panelin shqyrtues se kemi të bëjmë me pretendime të njejta ankimore të cilat paraprakisht janë shqyrtuar nga ana e panelit shqyrtues dhe në baze të nenit 16.2 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2017, kemi të bëjmë me pretendim të njejtë ankimore për të cilat paraprakisht PANELI SHQYRTUES ka marrur vendim.

Pretendimi ankimor nr.1- 2A GROUP SH.P.K&GPG COMPANY SH.P.K,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesave të juaja obligative sipas *SEKSIONI II, FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FDT), Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 Dëshmitë pika 2, Deklarata nga Banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në gjirollogari në vlerë prej 200,000.00€, ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucionet bankar.*

Ne jemi të mendimit se OE ankues 2A Group SHPK nuk e ka përmbush kriterin sipas kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (fq.10 e dosjes së tenderit neni 8.1 pika 2) pasi që në dokument të lëshuar nga Banka për Biznes (BPB) për OE 2A Group SHPK shkruan decidivisht se: **Aplikanti 2A Group SHPK ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe Banka në të ardhmen mund të përkrah me kredi, letër kredi, garancione bankare, nëse kërkesat e tij janë në harmoni me ekspozimet kreditore të lejuara nga ligji për bankat, rregullat e BQK-së.**

Në bazë të kërkesës së FDT-së dhe njoftimit për kontrat pika 8.1.2 në lidhje me këtë kërkes është kërkuar : *Deklarata nga Banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në gjirollogari në vlerë prej 200,000.00€, ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucionet bankar" . Eksperti shqyrtues mendon se NUK është përmbusher në tërësi kërkesa e lartë cekur, duke u bazuar në këtë letër përkrahje të ofruar nga OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit.*

Eksperti shqyrtues vlerëson se në lidhje me këtë kërkes Paneli shqyrtues ka marrë vendim të të shpallë të papërgjegjshem edhe OE I cili paraprakisht ishte REKOMANDUAR për dhënien e kontratës në lidhje me këtë aktivitet të Prokurimit, dhe njëherit qëndron arsyatimit I dhënë nga ana e Autoritetit kontraktues në lidhje me eliminimin e OE ankues sa I përket kësaj pike, se I njejti NUK e ka përmbushur kërkesën sipas ashtu siç është kërkuar në FDT.

Në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga ana e OE-ve ankues sa I përket arsyetimit të dhënë në letër standarte nga ana e AK-së se kontrata për këtë aktivitet të Prokurimit është ANULUAR në munges të tri (3) ofertave të përgjegjshme,

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndrojnë pretendimet e OE-ve në lidhje me këtë pikë sepse NUK është e nevojshme që të jenë tri oferta të përgjegjshme për të vazhduar me lidhjen e kontratës në një aktivitet të Prokurimit, dhe si arsyetim I dhënë në këtë form nga ana e AK-së është I pakuptimt dhe në kundërshtim me LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të Aprovoj PJESËRISHT si të bazuar ankesën e OE ankues "*2A GROUP SH.P.K&GPG COMPANY SH.P.K*", me seli në Prishtinë, njëherit të HUDHË POSHTË si të pa-lejuar ankesën e OE-ve ankues "RENELUAL TAHIRI, për këtë aktivitet të prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë", me nr. prokurimi: MI-16-050-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastruktures.

Eksperti shqyrtues njëherit REKOMANDON Panelin shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të ANULOHET në tërësi në munges se asnjëri nga OE pjesëmarrës NUK kanë përmbushur në përpikëri kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontrat.